



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përherhme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturore, Peizazh kulturor

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Patrikana e Pejës

Fotografi pamje karakteristike, dt. 2016





Data/t kryesore të themelimit të asetit
Periudha/t historike (ShekXII.)

Adresa, Qyteti/Fshati, Komuna Pejë

Lloji i asetit të propozuar
(Kategoria ligjore dhe Nënkatëgoria sipas nenit 2 të LTK)
Sakrale – Manastir

Numri i inventarit (unik) 002087

Numri i regjistrimit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/ referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Akti i mëhershëm nëse ka

Data e mbrojtjes: Nën mbrojtje të përhershme

Lloji i mbrojtjes: Nën mbrojtje të përkohshme Data e mbrojtjes:

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Të përshkruhet arsyetimi se përse aseti i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti


Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nent 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlerat historike, Vlerat artistike, Vlerat shoqërore dhe shpirtërore

Propozuesi:

Institucioni: QRTK-Pejë.

Emri/ Mbiemri: Shpresa Gjonbalaj

Nënshkrimi 

Adresa dhe kontakt informacione: **Rr..Enver Hadri Nr. 75 Pejë**

Data : 28/09/2016

Bashkangjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Mbrojtja dhe menaxhimi i asetit/Masat juridike dhe teknike
6. Monitorimi
7. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt.../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Pejë

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit

Qyteti i Pejës gjendet ne skajin veri-perëndimor te luginës se pëlleshme te Dukagjinit, para grykës piktoreske nën shpatijet e Alpeve Shqiptare.

Si vendbanim daton që nga kohërat më të hershme Ilire. Njihet si qyteti më i rëndësishëm i Dardanisë Antike. Në këtë lokalitet është zbuluar një numër objektesh arkeologjike, që na bëjnë edhe më bindës se këtu duhet të ketë qenë një qendër administrative municipale e tërë rrafshit të Dukagjinit...

Në kohën antike dhe në mesjetë deri në shek XV qyteti shtrihej pikërisht në fushë duke filluar nga arat e quajtura „Gradinë”, ku janë gërmadhat e Pejës antike, d.m.th. nga tyrbja e „Sari Salltëkut” ku tani gjendet fabrika e baterive në Lindje, e deri te stacioni hekurudhor më saktë deri te kalaja në Perëndim.

Pejën gjatë historisë e hasim me emra të ndryshëm si: në kohën antike Iliro-Romake është quajtur Siparantum, kurse gjatë mesjetës quhej: Pech (Pekë, P(j)ekë)), Peka, Pentza dhe Forno, Peja, e cila në dokumentet latine figuron në formë Pechi (1202), me sa dihet ky është dokumenti më i vjetër i ruajtur i asaj periudhe.

Në atë kohë në Pejë ishte e zhvilluar tregtia. Aty ekzistonte Kolonia e Dubrovnikasve.

Peja si Siparant Dardan përmendet në hartën „Gjeografia” e Ptolemeut në shekullin III-IV (nën sundimin e romakëve) civilizimi i të cilit arrin shkallën më të lartë të lulëzimit, dhe ka pasur statusin e Municipiumit, andaj edhe bëhet një nga qytetet kryesore të Dardanisë pas Ulpianës (Prishtina e sotme).

Peja me rrethinë pas betejës së Kosovës (1389) e deri më 1462 administrohej njëherë nga Balshajt (1378) e pastaj nga Dukagjinasit.

Historia e Pejës është e lidhur ngushtë edhe me familjen e Dukagjinasve Leka dhe Pali e geverisnin vendin bashkërisht. Në kohën e luftës së Gjergj Kastriotit kundër perandorisë Osmane, deri me 1462 me këtë qytet sundonte Lekë Dukagjini III.

Për disa dekada deri në dyzetëvjetshin e shek. XVI ishte në suazën e Sanxhakut të Shkodrës. Është interesante të përcillet ndërrimi i influencave të ndryshme etno-kulturore në vendbanimin e Pejës, prej godinave Dardane, romake, bizantine, sllave, dhe turko-orientale. Kështu, me të gjitha vlerat kulturore popullore shqiptare (arkitektura, skulptura, doket dhe zakonet dardane) të trashëguara nga antika, Bizanti, madje edhe mesjeta, që e gjetën Osmanët, kohë pas kohe e plotësuan me ndërtime të reja. Ardhja e turqve solli një influencë shumë të fortë të kulturës osmane-islame në jetën shpirtërore dhe kulturën materiale të kësaj treve. Në këtë pikëpamje janë karakteristike: kompleksi i patrikanës së Pejës, kullat e shekujve XII-XIX, sarajet e Pejës, xhamitë, teqetë, mesxhidet, varrezat, tyrbet, mullinjët, hanet, sahatkullat, urat, shatërvanët, krojet publike (çesmet), kainaket, hamamet (banjot publike) etj. Peja gjatë shekujve ishte qendër ekonomike – kulturore, e në mbarim të shek XIX u bë edhe qendër e Rilindjes Kombëtare në krye me Haxhi Zekën, në luftë kundër pushtuesit turk, për të fituar pavarësinë. Peja me 29 tetor 1912, u çlirua nga pushtuesit turk, po në atë datë u pushtua nga malazezët. Në nëntor të 1915, ra nën sundimin Austro-Hungarez.

Me 1919 ra nën okupimin e mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene gjer në vitin 1941 kur ra nën sundimin Italian dhe pas dy viteve në vitin 1943 ishte nën administrimin e regjimit të nazi-fashizmit gjerman. Në vitin 1945 ishte nën sundimin e ish Jugosllavisë ndërsa pas intervenimit të NATO-ës në vitin 1999, të përkrahura nga populli i Kosovës, me 16. Qershor 1999 arrihet çlirimi. Tani Komuna e Pejës është njësi territoriale administrative, në të cilën qytetarët realizojnë vetëqeverisjen e tyre, në pajtim me Legjislacionin në fuqi. Ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale.

Te dhënat e paraluftës tregojnë se qyteti ka pasur 95.723 banorë, kurse sot në Pejë jetojnë afro 200.000 banorë. Komuna e Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale. Gjuha dominuese në rrethin e Pejës është ajo shqipe. Megjithatë në zonat ku jetojnë popullsia serbe dhe boshnjake flitet gjuha serbe dhe boshnjake.

- Në Pejë, ashtu si po thuaj kudo në Kosovë, do të gjeni të kombinuara besime të ndryshme fetare. Dominon besimi mysliman, por është prezent edhe besimi i krishterë dhe ortodoks.

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda
20°17'39.02" E 42°39'42.18" N

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Perimetri i asetit të propozuar: _____ ha
Zona rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: _____ ha
Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zones rrethuese $P=1:500$ dhe $1:200$.
- Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.
- Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratografinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

Patrikana e Pejës

Në rrugën që shpie në grykën magjepsëse të Rugovës, gjendet Patrikana e Pejës.

Zhvillimi i qytetit të Pejës është i lidhur ngushtë me zhvillimin e këtij monumenti, një qendër e rëndësishme kulturore e politike e cila daton që nga fillimet e shek.XIII-të.

Kisha ekzistuese Patrikana e Pejës është e ndërtuar në shek.XII-të, dhe është ndër monumentet e rëndësishme të periudhës së vonshme bizantine në Europë.

Të katër ndërtesat e objektit reflektojnë pika të larta të kulturës bizantino-romake e cila është zhvilluar në Ballkan në mes të shekujve XII,XVII me një stil të veçantë të pikturave murale.

Patrikana e Pejës është një grup prej katër kupolave kishtare,në periferi të Pejës e pikturuar me një seri të pikturave murale.

Freskat e shek.XIII të kishës së Shën Apostolit janë të pikturuara në mënyre unike,me një stil monumental.

Në fillim të shek XIV freskat në kishën e Virgjëreshës së Shenjtë përfaqësojnë dukjen e stilit të ri të renesancës të ashtuquajtur Palaiologian,duke gërshetuar influencën e stilit lindor Ortodoks-Bizantin si dhe traditën perëndimore Romake.

Ky stil ka luajtur rol vendimtar në artin pauses Ballkanik. Sipas disa burimeve historike

Patrikana e Pejës në shek. XIII është ndërtuar në themelet e tri kishave të madhësisë së vogël katolike-romake të cilat i ka shfrytëzuar popullata shqiptare.

Shqiptarët këtë monument e konsiderojnë si trashëgimi kulturore të Kosovës të uzurpuar nga klerikët serbë me qendër në Beograd.

Argumentet bazë sipas tyre janë disa dokumente historike ku thonë se për objektin janë përkujdesur edhe shqiptarët. Kujdesin e familjeve shqiptare ndaj këtij objekti e ka pranuar edhe vet patriarku serb Gnerman në Pejë në vitin 1960,me dekorimin e familjes shqiptare Nikçi nga Rugova për mbrojtjen e Patrikanës së Pejës brez pas brezi.Kjo është tradita shqiptare qysh nga shek XIV dhe XV.

Qe nga viti 2002 INTERSOS-i në bashkëpunim me Institutin Qendror për Restaurim në Romë, është duke përcjellur evoluimin në tërësi të strukturës dhe të freskave .

Patrikana e Pejës është shpallur monument nën mbrojtje të ligjit nr.v.428/46,me 25.10.1946.Të gjitha të drejtat I takojnë edhe me ligjin për trashëgiminë kulturore të Kosovës nr.02/L-88,më 09.10.2006 dhe ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura nr.03/L-039,më 20.02.2008 të aprovuar nga parlamenti I Kosovës,ku edhe Patrikana e Pejës është “zonë e posaçme” dhe mbrohet sipas nenit 2,7 të këtij ligji. Por edhe me ligjin për planifikim hapësinor të Kosovës nr.2003/14.

Shtojçë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në $P=1:200$, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës Rëndësia/vlera/t

Kriteret/vlerat/ interesi

- *Përshkrimi i attributev/vlerave të asetit sipas kriterëve të përcaktuara në Nenin 4, të Rreg.Nr.5.2008/MKRS)*
- **Vlerat historike:** Patriakana e Pejës me vjetërsinë dhe origjinalitetin e ruajtur deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore dhe arkitekturore gjate shek XII-XIII ,në Pejë.
- **Vlerat artistike:** Patriakana e Pejës cilësohet si një ndër veprat monumentale me vlera historike, kulturore, arkitekturale e artistike. Krahas arkitekturës, teknikës së ndërtimit, shquan edhe me shumë dekoracione, e afreska.
- **Vlerat shoqërore:** Krahas vlerave historike, teknike dhe estetike, Patriakana ka vlerë të rëndësishme në aspektin shoqërorë. Ka qenë dhe është vendtakim i qytetareve të cilët praktikojnë ritualet spirituale dhe fetare.
- **Vlerat shpirtërore:** Është ndërtesë ku aktualisht aplikohet religjioni fetar ortodoks. Dhe konsiderohet si njëra prej monumenteve me vlera të veçanta në regjion.

Kategoria e rëndësisë

Sakrale

- *Lokale, nacionale, ndërkombëtare.*
Lokale

Zhvillimi historik i asetit

Patrikana e Pejës

Në rrugën që shpie në grykën magjepsëse të Rugovës, gjendet Patrikana e Pejës.

Zhvillimi i qytetit të Pejës është i lidhur ngushtë me zhvillimin e këtij monumenti, një qendër e rëndësishme kulturore e politike e cila daton që nga fillimet e shek.XIII-të.

Kisha ekzistuese Patrikana e Pejës është e ndërtuar në shek.XII-të, dhe është ndër monumentet e rëndësishme të periudhës së vonshme bizantine në Europë.

Të katër ndërtesat e objektit reflektojnë pika të larta të kulturës bizantino-romake e cila është zhvilluar në ballkan në mes të shekujve XII,XVII me një stil të vecantë të pikturave murale.

Patrikana e Pejës është një grup prej katër kupollave kishtare,në periferi të Pejës e pikturuar me një seri të pikaturave murale.

Freskat e shek.XIII të kishës së Shën Apostolit janë të pikturuara në mënyre unike,me një stil monumental.

Në fillim të shek XIV freskat në kishën e Virgjëreshës së Shenjtë përfaqësojnë dukjen e stilit të ri të renesansës të ashtuquajtur Palaiologian,duke gërshetuar infuelcën e stilit lindor Ortodoks-Bizantin si dhe traditën perëndimore Romake.

Ky stil ka luajtur rol vendimtar në artin pauses Ballkanik. Sipas disa burimeve historike Patrikana e Pejës në shek. XIII është ndërtuar në themelet e tri kishave të madhësisë së vogël katolike-romake të cilat i ka shfrytëzuar popullata shqiptare.

Shqipëtarët këtë monument e konsiderojnë si trashëgimi kulturore të Kosovës të uzurpuar nga klerikët serbë me qendër në Beograd.

Argumentet bazë sipas tyre janë disa dokumente historike ku thonë se për objektin janë përkujdesur edhe shqiptarët. Kujdesin e familjeve shqiptare ndaj këtij objekti e ka pranuar edhe vet patriarku sërb Gnerman në Pejë në vitin 1960,me dekorimin e familjes shqiptare Nikçi nga Rugova për mbrojtjen e Patrikanës së Pejës brez pas brezi.Kjo është tradita shqiptare qysh nga shek XIV dhe XV.

Qe nga viti 2002 INTERSOS-i në bashkpunim me Institutin Qendror për Restaurim në Romë, është duke përcjellur evluimin ne tërësi te strukturës dhe të freskave .

Patrikana e Pejës është shpalluar monument nën mbrojtje te ligjit nr.v.428/46,me 25.10.1946.Të gjitha te drejtat i takojnë edhe me ligjin për trashëgiminë kulturore të Kosovës nr.02/L-88,më 09.10.2006 dhe ligjin për zonat e vecanta të mbrojtura nr.03/L-039,më 20.02.2008 të aprovuar nga parlamenti I Kosovës,ku edhe Patrikana e Pejës është “zonë e posaçme” dhe mbrohet sipas nenit 2,7 të këtij ligji.Por edhe me ligjin për planifikim hapësinor të Kosovës nr.2003/14.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

Patrikana e Pejës paraqet një kompleks kishash të ndërtuara në periudha të ndryshme kohore. Objekti më i vjetër supozohet se është një kishë bizantine data e ndërtimit të së cilës nuk dihet saktësisht.

Në vitin 1266 ndërtohet kisha e dytë e ngjitur me të parë nga një murg Arsenije I (d.1266). Ndërsa në vitin 1330 u ndërtua kisha e tretë nga peshkopi Danillo II.

Më vonë në front të këtyre kishave ndërtohet edhe narteksti i cili edhe e përfundon ndërtimin në përgjithësi.

Në aspektin arkitektonik Patrikana e paraqet stilit bizantin të ndërtimit të kishave ortodokse e cila mund të haset kudo në ballkan. mbulesat e kupolave dhe kulmit të narteksit janë nga plumbi. Teknika e ndërtimit është e thjhtë me gurë dhe llaç.

Në aspektin komparativ objekt të ngjajshëm nuk kemi në Kosovë por në Ballkan ka mjaft objekte të kësaj arkitekture dhe teknike të ndërtimit.

Në aspektin e ruajtjes së autenticitetit kemi të bëjmë me një ekzemplar të cilit pas ndërhyrjeve të viteve të fundit i është ndërruar pamja mjaft sidomos me lyerjen e saj me ngjyrë të kuqe me çka ka humbur shumë nga ana e autenticitetit.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

Gjendja teknike e kompleksit është relativisht e mirë, dhe ka ruajtur shumë elemente origjinale, por intervenimet në fasadë e kanë degraduar pamjen.

Gjatë ndërhyrje restauruese QRTK-Pejë nuk ka pasur qasje dhe nuk është lejuar të mbikëqyrë punimet.

Ndikimi i rrethinës është mjaft i madh i vogël pasi që në afërsi të monumentit nuk ndërtime (pos atyre konaqeve) dhe është mjaft e izoluar nga rrethina sidomos me muret e gurit të ndërtuara pas luftës.

5. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I ASETIT/POLITIKA, MASAT JURIDIKE DHE TEKNIKE

- Programet/Planet e promovimit, interpretimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së autenticitetit/integritetit të asetit, duke specifikuar nevojen dhe planet për ndërhyrje hulumtuese, riparimi urgjent, restaurimet dhe adaptimet për përdorim bashkëkohorë.
- Përdorimi i ndërtesës dhe shfrytëzuesit/pronari
- Statusi i asetit në relacion me legjislacion për planet e zhvillimit territorial dhe programet tjera zhvillimore.
- Relacioni i mbrojtjes së asetit me Planet ekzistuese zhvillimore të qytetit, fshatit, Komunës dhe Planin Hapsinorë të Kosovës.
- Sistemi i menaxhimi të asetit
- Resurset financiare vjetore në dispozicion apo të nevojëshme
- Resurset profesionale në dispozicion dhe nevojat
- Kushtet për vizitor dhe statistikat

Shtojcë4: Projekt propozimet për punë hulumtuese dhe teknike, dhe Plani i menaxhimit të asetit

6. MONITORIMI/INSPEKTIMI

Monitorimi dhe inspektimi i asetit nuk mund të bëhet nga Institucionet vendore. Ngase Patriakana nuk lejon që QRTK-Pejë të bëjë incizimin dhe monitorimin e saj, sikur ndodh me monumentet tjera në rajonin e Pejës.

Ndaj edhe raportimi dhe qasja është thuaja e pamundur, ngase autoritetet kishtare që menaxhojnë monumentin, nuk lejojnë qasje për institucionet vendore.

7. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi, slajda dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershme mbi statusin ligjor të asetit.*
- *Shtojcë 1, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Shtojca 2, Planet e situacionit të asetit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zones rrëthuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelt, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.*
- *Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*
- *Shtojcë4: Projekt propozimet për punë hulumtuese apo ndërhyrje teknike dhe Plani i menaxhimit të asetit të propozuar për mbrojtje.*

8. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni ...QRTK – Pejë

Hartuesit e formularit: Shpresa Gjonbalaj- Drejtor i QRTK-Pejë

Arsim Mulhaxha- Ark. ARSIM MULHAXHA

Adresa Rr. Enver Hadri Nr. 75

Konakt Tel/Faks/email, web faqe

..039 434 147

Data 28/09.2016

Nënshkrimi